



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 683/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|-----------------|------------|
| Evis Shurdha | Kryetar |
| Leonard Gremshi | Zv/Kryetar |
| Hektor Balluku | Anëtar |
| Kleves Janku | Anëtar |
| Odise Moçka | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 04.10.2017, shqyrtoi ankesat me:

Objekt:

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k., në procedurën e prokurimit, "Procedurë e Hapur", me objekt "Sistemim asfaltim rruga e fshatrave Grazhdan, Pilafe, Majtare e Poshtëme dhe Lagjes Aksioni, Peshkopi", me nr. REF-21545-07-19-2017, me fond limit 50,971,385 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "SELAMI" sh.p.k., si dhe lënien në fuqi të vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertave të operatorit ekonomik "GJOKA KONSTRUKSION" sh.p.k. dhe BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k.
Adresa: Dibër, Melan, Veshaz..

BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k.
Adresa: Lagjia "Pjetër Budi", Burrel, Dibër..

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Dibër.
Adresa: Bulevardi "Eles Isufi", Dibër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatorët ekonomik ankimes dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, operatorët ekonomik ankimes kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Operatorët ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

I.3. Ankimesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimes.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 20.07.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, "*Procedurë e Hapur*", me objekt "*Sistemin asfaltim rruga e fshatrave Grazhdan, Pilafe, Majtare e Poshtëme dhe Lagjes Aksioni, Peshkopi*", me nr. REF-21545-07-19-2017, me fond limit 50,971,385 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.

II.2 Në datën 15.08.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 23.08.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | | |
|------|----------------------------------------------------|--------------------------------|
| i. | ”GJOKA KONSTRUKSION” sh.p.k | 43,032,185 lekë, skualifikuar; |
| ii. | ”EURALDI” sh.p.k & ”CURRI” sh.p.k | 45,929,826 lekë, skualifikuar; |
| iii. | ”SELAMI” sh.p.k. | 49,750,177 lekë, kualifikuar; |
| iv. | ”VLLAZNIA NDËRTIM IS” sh.p.k & ”NDREGJONI” sh.p.k. | 50,726,241 lekë, skualifikuar |

II.4.Në datën 23.08.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE ”EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

”EURALDI Sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentat e meposhteme per kualifikim ;

1. Vertetim per shlyerjen e detyrimeve tatimore qe lindin nga ushtrimi i aktivitetit .Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore eshte i dates 31.03.2017 pra nuk ploteson kriteret e pergjitheshme te DST pika 1 ku thuhet “ Dokumentat e mesiperme duhet te jene te leshuar jo me shume se tre muaj data e hapjes se ofertave” .

2. Nuk ploteson piken 1.3.8 te DST Operatori ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzoje analizë teknike për të gjithë e preventivin e ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar për bën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15.8.2007, “Përinformatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.”

II.4.1. Në datën 28.08.2017 BOE ankimes ”EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe ka ngritur pretendime mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik ”SELAMI” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Arsyet e skualifikimit te ofertes tone jane si me poshte vijon:

1.Vertetimi per shlyerjen e detyrimeve tatimore qe lindin nga ushtrimi i aktivitetit Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore per “EURALDI” sh.p.k eshte i dates 31.03.2017,pra nuk ploteson kriteret e pergjithshme te DST pika 1 ku thuhet “Dokumentat e mesiperme duhet te jene te leshuar jo me shume se tre muaj nga data e hapjes se ofertave”.

2.Nuk ploteson piken 2.3.8 te DST ku operatori ekonomik pjesmarres ne tender se bashku me preventivin duhet te dorezoje analize teknike per te gjithë preventivin e oferten.

Ne lidhje me keto dy kritere qe nga ana e Autoritetit Kontraktor jane cilesuar si te paplotesuara nga operatori ekonomike kerkojme nga ana juaj rivleresimin dhe verifikimin e dokumentacionit pasi ne piken nr.1 vertetimi i “EURALDI”sh.p.k per shlyerjen e detyrimeve tatimore qe lindin nga ushtrimi i aktivitetit eshte leshuar me date 15.05.2017,pra eshte brenda afatit 3-mujor. Ne piken nr.2 ku kerkohet analize teknike e te gjithë preventivin e ofertes u kerkojme te rivlersoni dhe te verifikoni formularin e ofertes tone ekonomike pasi te gjithë zerat e preventivit jane te shoqeruara me numrin e analizës teknike, te paraqitura ne kollonen e dyte te tabelës te ofertes ekonomike.

Per keto arsye ne kerkojme nga ana juaj:

1.Rivleresimin e dokumentacionit te prokurimit dhe kualifikimin e ofertes tone.

2.Rivleresimin e dokumentacionit te prokurimit te operatorit ekonomik te shpallur fitues "SELAMI" sh.p.k dhe skualifikimin e oferten se tyre per arsye edhe te mungeses se dokumentacionit nga ana e tyre. [...]"

II.4.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 3993/1 Prot. datë 04.09.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k., duke e pranuar pjesërisht ankesën e tij, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Për sa me siper, Komisioni Përgjegjës për Shqyrtimin e Ankesave veren se:

1.Per sa i perket ankeses se operatorit ekonomik "Euraldi" shpk mbi kriterin e skualifikimit per "Mosparaqitja në formën e kërkuar përbrën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM Nr.514, datë 15. 8.2007, "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", pika 10)" KSHA pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga OE Euraldi shpk veren se oferta ekonomike e nuk eshte paraqitur ekzaktesisht sipas kesaj pike por duke qene se cdo ze nga zerat e punimeve eshte paraqitur me numer analize teknike ne perputhje me Manualin e Cmimeve 2015 edhe si e tille mund te pranohet nga AK. Pra ankesa e OE qendron.

2.Per sa i perket ankeses se operatorit ekonomik "Euraldi" shpk mbi kriterin e skualifikimit per " Vertetim per shlyerjen e detyrimeve tatimore qe lindin nga ushtrimi i aktivitetit . Vertetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore eshte i dates 31.03.2017 pra nuk ploteson kriteret e pergjitheshme te DST pika 1 ku thuhet "Dokumentat e mesiper duhet te jene te leshuar jo me shume se tre muaj nga data e hapjes se ofertave" KSHA pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga OE Euraldi shpk veren se AK eshte ne te drejten e tij per te skualifikuar OE per shkak se ky vertetim nuk i permbush kriteret e pranimet ne Kriteret e Pergjitheshme te Kualifikimit pika 2 a dhe b pasi eshte per me shume se tre muaj nga hapja e ofertave . Pra ankesa e OE nuk qendron.

3. Per sa i perket ankeses se operatorit ekonomik "Euraldi" shpk mbi skualifikimin e OE "SELAMI" shpk te shpallur fitues nga ana e KVO kjo ankesa eshte e pa argumentuar dhe e pa arsyeshme pasi BOE "EURALDI" shpk dhe "CURRI" nuk kualifikohen si OE si dhe nuk kane dhene arsye te mjaftueshme per skualifikimin e OE "SELAMI" shpk. Pra kjo ankesa nuk qendron.[...]"

II.4.3.Në datën 08.09.2017 pala ankimuese BOE ankimues "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5.Në datën 23.08.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyen si më poshtë vijon:

"[...]Vllaznia Ndertim I.S. nuk ka paraqitur dokumentat e meposhteme per kualifikim ;

Ne kontratat e ngjashme te paraqitur nga subjekti Vllaznia Ndertim IS shpk nuk ka zera pune te njejte me ato te kerkuara ne preventivin e AK ne perqindje me kontraten e bashkepunimit me Ndregjoni shpk .[...]"

II.5.1.Në datën 29.08.2017 BOE ankimues "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe duke ngritur pretendime në lidhje me ofertat e paraqitura nga operatori ekonomik "SELAMI" sh.p.k. dhe BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më posht vijon:

"[...]Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Vllaznia Ndertim IS" shpk & "Ndregjoni" shpk kanë marrë pjesë në këtë procedurë sipas Akt Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe janë ndarë punimet në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar punimet që merr përispër secila palë. Objektet e paraqitura nga secili janë në përputhje të plotë me natyrën e punimeve të marra pësispër nga secili dhe në vlerë që plotësojnë dhe kalojnë raporte me përqindjen e marrë përispër. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Vllaznia Ndertim IS" shpk & "Ndregjoni" shpk ka dorëzuar akt marrëveshjen (për bashkimin e përkohshëm të shoqërive më datë 09.08.2017 nr.7304 rep, nr.5680 kol mbi bashkimin e përkohshëm të 2 shoqërive, ku shprehet qartë se shoqëria "Vllaznia Ndertim IS" shpk merr përispër kryerjen e 40 % të punimeve, shoqëria "Ndregjoni" shpk 60 % të punimeve. Gjithashtu pjesë e akt marrëveshjes është edhe tabela e ndarjes së punimeve, ku është përcaktuar me kaptill dhe zëra sipas preventivit për punimet që merr përispër secila firmë. Meqënëse punimet e marra përispër nga shoqëria "Vllaznia Ndertim IS" shpk përfshijnë punime punime gjermimi, Shtesash dhe asfaltimi, punime elektrike, betonarmeje , KUZ , Tuba celiku ,sinjalistike (refero ndarjes së punimeve-punimeve që do të kryehen nga shoqëria "Arifaj" shpk) në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka dorëzuar kontratat mbi punime të ngjashme të kryera në objekte rrugë dhe ndërtime civile, të cilat e tejkalojnë vlerën e kërkuar sipas përqindjes përkatëse... Sipas raportit të pjesëmarrjes shoqëria "Vllaznia Ndertim IS" shpk duhej të paraqiste kontrata të ngjashme shuma e të cilave të ishte 101,942,770 X 40 % =40,777,108 lekë kurse vlera e kontratave të paraqitura është 71,052,728 lekë pra duke e tejkeluar vlerën e kërkuar. Shoqëria " Vllaznia Ndertim IS " Sh.p.k , ka paraqitur paraqiste kontrata të ngjashme sipas raportit të pjesëmarrjes , pretendimi i KVO nuk qendron. Vendimi i KVO-se duke skualifikuar shoqërine B.O , " Vllaznia Ndertim IS & Ndregjoni Sh.p.k eshte i padrejte. Shoqërine B.O " Vllaznia Ndertim IS & Ndregjoni " Sh.p.k kerkon që të skualifikohen operatorët ekonomik Selami Shpk dhe B.O " CURRI & EURALDI " Sh.p.k. I. Shoqëria jonë gjykon se AK ka kualifikuar operatorin ekonomik " SELAMI" shpk në kundërshtim me dispozitat e prokurimit publik dhe kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST. Në nenin 46 të LPP në arsyet e skualifikimit përcaktohet :” Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktori vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: Operatorët e Ekonomik Selami Shpk nuk ploteson dokumentat standare të Tenderit, shtojca 10, “Kërkesat e Veçanta për kualifikim”, pika 2.2 , 2.3.3 dhe 2.3.5. II “ CURRI & EURALDI " Sh.p.k nuk ploteson dokumentat standare të Tenderit. shtojca 10, “Kërkesat e Veçanta për kualifikim” [...]”

II.5.2.Në datë 04.09.2017 autoriteti kontraktor i kthen përgjigje BOE ankimues "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k. me anë të shkresës Nr. 4021/1 Prot. datë 04.09.2017., duke mos pranuar ankesën e tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

"[...]Për sa me sipër, Komisioni Përgjegjës për Shqyrtimin Ankesave verën se ,,

1. Per sa i perket ankeses se operatorit ekonomik BOE VLLAZNIA NDERTIM IS shpk & NDREGJONI shpk mbi kriterin e skualifikimit per "Ne kontratat e ngjashme te paraqitur nga subjekti Vllaznia Ndertim IS shpk nuk ka zera pune te njejte me ata te kerkuara ne preventivin e AK ne perqindje me kontraten e bashkepunimit me Ndregioni shpk "KSHA pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur nga OE veren se kjo ankese eshte e pabazuar. 2. Per sa i perket ankeses se Operatorit ekonomik BOE VLLAZNIA NDERTIM IS shpk & NDREGJONI shpk mbi skualifikimin e OE "SELAMI" shpk te shpallur fitues nga ana e KVO kjo ankese eshte e pa argumentuar BOE VLLAZNIA NDERTIM IS shpk & NDREGJONI shpk si dhe nuk kane dhene arsye te mjaftueshme per skualifikimin e OE "SELAMI" shpk. Pra kjo ankese nuk qendron [...]"

II.5.3.Në datën 08.09.2017 pala ankimuese BOE "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k.ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.Në datën 21.09.2017, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.4289/1prot., datë 13.09.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dhe kërkesave të operatorëve ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin "[...]1.Vertetimi per shlyerjen e detyrimeve tatimore qe lindin nga ushtrimi i aktivitetit Vertetimi i leshuar nga Administrata Tatimore per "EURALDI" sh.p.k eshte i dates 31.03.2017,pra nuk ploteson kriteret e pergjithshme te DST pika 1 ku thuhet "Dokumentat e mesiperm duhet te jene te leshuar jo me shume se tre muaj nga data e hapjes se ofertave [...]". Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën nr. 10, pika 2 "Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit" në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

"2.Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):a)ka plotësuar detyrimet fiskale, b)ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore. Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës."

III.1.2.Në përmbushje të kriterit të mësipërm pjesëtari i bashkimit të operatorëve ankimues, operatori ekonomik "EURALDI" sh.p.k ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Vërtetim për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, nr.2052prot, datë 15.05.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër.
2. Vërtetim xhiro për vitet 2014, 2015, 2016, nr.2053prot, datë 15.05.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër.
3. Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin për periudhën Janar-Qershor 2017, nr.2763prot., datë 01.08.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër.

III.1.3. Në nenin 45 pika 2, germat d) dhe dh) të LPP-së përcakohet se: “2. Çdo kandidat ose ofertues skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur: d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;”

III.1.4. Në nenin 45 pika 3, germa b) të LPP-së përcakohet se: “3. Autoriteti kontraktor pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente: b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh””

III.1.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.1.6. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterëve të pranimit/kualifikimit, KPP konstaton se operatori ekonomik “EURALDI” sh.p.k, pjesëtar BOE ankimues, ka dorëzuar 3 vërtetime të lëshuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, të cilat dy prej tyre mbajnë datën 15.05.2017 dhe një prej tyre mban datën 01.08.2017. Bazuar në faktin se procedura e prokurimit objekt ankimi është zhvilluar në datën 15.08.2017, KPP vëren se vërtetimet e dorëzuara nga operatori ekonomik “EURALDI” sh.p.k, janë lëshuar nga autoriteti përkatës brenda afatit 3 mujor të përcaktuar në mënyrë eksplicite në shtojcën nr. 10, pika 2 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi “Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumentave të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.” Në këto kushte, KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka vlerësuar drejtë dokumentacionin e dorëzuar nga BOE ankimues në përmbushje të kriterit të sipërcituar, dhe për rrjedhojë skualifikimi i ofertës së tyre për këtë arsye nuk qëndron. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit ose keqinterpretim i këtyre kriterëve.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “EURALDI” sh.p.k. & “CURRI” sh.p.k. qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin "[...]Vllaznia Ndertim I.S. nuk ka paraqitur dokumentat e meposhteme per kualifikim ; Ne kontratat e ngjashme te paraqitur nga subjekti Vllaznia Ndertim IS shpk nuk ka zera pune te njejte me ato te kerkuara ne preventivin e AK ne perqindje me kontraten e bashkepunimit me Ndregjoni shpk [...]". Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën nr. 10, pika 2.3 "Kapaciteti teknik" në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

"Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën: 1. Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet në një vlerë jo më pak se 50% të fondit limit; ose 2. Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit të jetë jo më pak se 200% i fondit limit. Për te vërtetuar piken 1 ose 2 duhet te paraqisni :

a-Kontratë/kontratat nënshkruar nga palët. b-Situacion i përfundimtar të punimeve. c-Aktet e kolaudimit të punimeve. d-Aktin e dorëzimit të punimeve nga investitori. e-Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës 8."

III.2.2.Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k., pjesëtar i BOE ankimues, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë lidhur ndërmjet Bashkisë Mat dhe operatorit ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. me objekt: "Rikonstruksion i kanalit ujitës SEKA", datë 27.05.2016, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;
2. Kontratë lidhur ndërmjet Komuna Lis (Bashkia Mat) dhe operatorit ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. me objekt: "Ndërtim ujësjellësi fshati Shoshaj", datë 17.10.2012, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;
3. Kontratë lidhur ndërmjet Bashkisë Laç dhe operatorit ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "GJOKA KONSTRUKSION" sh.p.k. me objekt: "Rikonstruksioni kopshtit nr.1 në Bashkinë Laç (dy kate)", nr.1236prot., datë 14.07.2015, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;
4. Kontratë lidhur ndërmjet Autoriteti Rrugor Shqiptar (Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër) dhe operatorit ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k. me objekt: "Mirëmbajtje rutine e dimërore rruga Burrel-Q.Bualli + Burrel-Komsi 36.7 km", datë 24.06.2013, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;
5. Kontratë sipërmarrje lidhur ndërmjet Komuna Martanesh dhe operatorit ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. me objekt: "Sistemim, asfaltim i rrugës jugore në qytetin e Krastë-Martanesh", nr.03, datë 18.06.2014, shoqëruar me dokumentacionin përkatës;
6. Kontratë për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, nr.7304rep, nr5680kol, datë 09.08.2017, lidhur ndërmjet operatorit ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. dhe operatorit ekonomik "NDREGJONI" sh.p.k., shoqëruar me preventivin e ndarjes së punimeve sipas shoqërive;

III.2.3.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.2.4.Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.2.5.Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6.Neni 26, pika 6 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon : *“a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve.”*

III.2.7.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “VLLAZNIA NDËRTIM IS” sh.p.k. pjesëtar i BOE ankimues në mënyrë elektronike në SPE, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky i fundit ka paraqitur pesë kontrata të sukseshme sipërmarrje me autoritete kontraktore për punë të ngjashme, përkatësisht “Rikonstruksion i kanalit ujitës SEKA”, me autoritet kontraktor Bashkia Mat, me vlerë punimesh të realizuar 15,891,500 lekë pa TVSH, “Ndërtim ujësjellësi fshati Shoshaj”, me autoritet kontraktor Bashkia Mat, me vlerë punimesh të realizuar 27,514,518 lekë pa TVSH, “Rikonstruksioni kopshtit nr.1 në Bashkinë Laç (dy kate)” me autoritet kontraktor Bashkia Laç, me vlerë punimesh të realizuar 32,351,213 lekë pa TVSH, “Mirëmbajtje rutine e dimërore rruga Burrel-Q.Bualli + Burrel-Komsi 36.7 km”, me autoritet kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar (Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër), me vlerë punimesh të realizuar 35,908,169 lekë pa TVSH dhe “Sistemim, asfaltim i rrugës jugore në qytetin e Krastë-Martanesh”, me autoritet kontraktor Komuna Martanesh, me vlerë punimesh të realizuar 7,857,572 lekë pa TVSH. Gjithashtu, KPP konstaton se kontratën për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, e ngarkuar në SPE nga BOE ankimues për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, operatori ekonomik “VLLAZNIA NDËRTIM IS” sh.p.k. ka marrë përsipër të kryej 40% të kontratës objekt prokurimi dhe përkatësisht zërat e punimeve si më poshtë :

Objekti: Sistemim,Asfaltimi i rrugëve të brendshme të Lagjes Aksioni, Bashkia Diber

1.PUNIME DHERASH

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne trup rruge, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke, 918 m³
- 2.Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, 75 m³

2.PUNIME ASFALTIMI

- 2.Shtrese binderi me zall lavatrice,5cm,me makineri ,1300 m²
- 3.Shtrese stabilizant t=15cm, 300 m²
- 4.Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri, 1505 m²
5. Struktura monolite betoni C 20/25 per kunete 50x15cm, 27 m³
6. F V bordura betoni 20x35 cm, 360 m

3.PUNIME KUB

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke, 114 m³
- 2.Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize, 9 cope
- 3.F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm, 90 ml
- 4.F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm, 167 ml
- 5.Shtrese rere, 12 m³
6. Mbushje me cakell, 75 m³

4.PUNIME NE SINJALISTIKE

- 1.Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm.Termoplastike (sprajt) AKSI + ANESORET, 649.715 ml
- 2.Boje bikomponente (paste) per kalim kembesoresh, 25 m²
- 3.F V tabela rrugore te ndryshme D=90cm, 6 cope

Objekti: Rikonstruksioni rruges "Pilafe" Bashkia Diber

1.PUNIME TE NDRYSHME (PRISHJE)

- 1.Prishje mur ekzistues pa pastrim, 15 m³.
- 2.Transport dheu me auto deri 5.0 km, 15 m³.

2.PUNIME DHERASH

- 1.Prerje bime te vogla deri Φ 10cm, 352.66 m².
- 2.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne trup rruge, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke, 555 m³.
- 3.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke (kasonete), 115 m³.
- 4.Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 1 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke, 50 m³.
- 5.Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri (seksionim + kasonete), 250 m³.

3.PUNIME ASFALTIMI

- 5.F V bordura betoni 15x25 cm, 740 m.

4.PUNIME NDERTIMI MURE DHE KANALE

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke 115, m³.
- 2.Mbushje me zhavorr pas mureve, 130 m³.
- 3.Struktura monolite b/betoni C 7/10 me 25% gur, 237 m³.
- 4.Struktura monolite betoni C 16/20 per kanal, 12 m³
- 5.Shtrese zhavorr per mureve, 4.5 m³

5.PUNIME TUBA ÇELIKU

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke 25 m³.
- 2.Struktura monolite betoni C 20/25 per portale, 2 m³.
- 3.Tuba Çeliku f323.8/6.35mm,L=30m, 1.2 ton
- 4.Mbushje me cakell, 9 m³
- 5.Transport dheu me auto deri 5.0 km, 25 m³

6.PUNIME KUZ

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke, 170 m³.
- 2.Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 100 cm, 21 cope.
- 3.F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm, 160.0 ml.
- 4.F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm, 375.0 ml.
- 5 Mbushje me cakell, 30 m³
- 6.Grope septike me V = 6 m³ 1 cope.

7.PUNIME NE SINJALISTIKE

- 1.Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm.Termoplastike (sprajt) ANESORET, 1250 ml.
- 2.Boje bikomponente (paste) per kalim kembesoresh 30 m².
- 3.F V tabela rrugore te ndryshme D=90cm, 7 cope.
- 4.F V tabela rrugore treguese 60x20cm, 1 cope.

Objekti: Sistemim asfaltim rruga fshatit Majtare e Poshteme, Bashkia Diber

1.PUNIME TE NDRYSHME (Prishje, etj.)

1. Prishje struktura prej betoni, 3.5 m³

2 PUNIME SHTRESASH PER TRUPIN E RRUGES

- 1.Germim dheu me ekskavator 0.5 m³,b > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet, 764.0 m³
- 2.Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, 964.8 m³
- 3.Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, 772.8 m³
- 4.Shtrese stabilizant t=10cm, 5,152.0 m²
- 5.Shtrese stabilizant t=10cm, bankine, 1,100.0 m²
- 8.Transport dheu me auto deri 1.0 km m³ 120

3.PUNIMET NE TOMBINO

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m³, ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke 3.75 m³
- 2.Struktura monolite betoni C 16/20 (per portale), 1.25 m³
- 3.Tub Celiku F323.8/6.35mm,L=6ml,P=49.72kg/ml, 298.33 kg
4. Mbushje me zhavor, 0.25 m³

4 PUNIME BETONI

- 1.Struktura monolite betoni C 16/20 per brez betoni, 2.0 m³
- 2.Struktura monolite betoni C 16/20 per kunete 6.0 m³

5.PUNIME PER SINJALISTIKE

- 1.Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Akrelike, 2,200 ml
- 2.FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm, 4 copë

Objekti: Sistemim asfaltim rruga fshatit Grezhdan nga kryqezimi me aksin kombetar Peshkopi – Tirane, Bashkia Diber

1.PUNIME TE NDRYSHME (Prishje, etj.)

1. Prishje struktura prej betoni, 2 m³

2.PUNIME SHITESASH PER TRUPIN E RRUGES

- 1.Germim dheu me ekskavator 0.5 m³,b > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet, 387 m³
- 2.Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, 268 m³
- 3.Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri, 373 m³
- 4.Shtrese stabilizant t=10cm, 2,484 m²
- 5.Shtrese stabilizant t=10cm, bankine, 540 m²
- 8.Transport dheu me auto deri 1.0 km, 119 m³

3.PUNIMET NE TOMBINO

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.15 m³, ne themele, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke 3.75 m³.
2. Struktura monolite betoni C 16/20 (per portale), 1.25 m³
- 3.Tub Celiku F323.8/6.35mm,L=6ml,P=49.72kg/ml, 298.33 kg
- 4.Mbushje me zhavor, 0.25 m³

4 PUNIME KANAL BETONI, L=50 ml

- 1.Germim dheu me ekskavator 0.5 m³,b > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet, 5.00 m³
- 2.Mbushje me cakell pas mureve, 2.00 m³
- 3.Struktura monolite betoni C 16/20 per kanale anesore L=825m, 6.8 m³

5.PUNIME PER MURE

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke 22 m³
- 2.Mbushje me zhavorr pas mureve 15 m³
- 3.Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur, 44 m³

6.PUNIMET E VEPRAVE TE ARTIT / Ndertim Ure Hd =3m

- 1.Germim dheu me ekskavator goma 0.35~0.40m³, ne themele, toke zak, kat III, me shkarkim ne toke, 35.00 m³
- 2.Struktura monolite betoni C 25/30,per ballna, mure, jastek 32.00 m³
- 3.F V soletone b/a M 300, 4.50 m³
- 4.Struktura monolite betoni C 16/20, per shpatulla m³ 31.00
- 5.Shtrese betoni C 12/15, bordure, trotuar, 0.60 m³
- 6.F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm, 511.04 kg
- 7.Mbushje me zhavorr pas mureve, 38 m³

7.PUNIME PER SINJALISTIKE

- 1.Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Akrelike, 1,080 ml
- 2.FV tabela te ndryshme rrugore D=60cm, 4 copë

III.2.8. Për të dhënë një gjykim sa më të drejtë dhe në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, Komisioni i Prokurimit Publik, shqyrtoi preventivat e kontratave të paraqitura në tender nga operatori ekonomik ankues, nga ku konstatoi se në të tërësi zërat e punimeve të kontratave të paraqitura nga operatori ekonomik i sipërpërmendur, janë të ngjashme me zërat e punimeve që janë marrë përsipër të kryhen nga operatori ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. në kontratën e bashkimit të përkohshëm të sipërcituar, pavarësisht pretendimit të autoritetit kontraktor, i cili deklaron se operatori ekonomik "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k., nuk plotëson pikën e mësipërme për kualifikim, pasi kontratat e paraqitura nga ky operator ekonomik, nuk kanë zëra pune të njëjtë me ato të kërkuara në preventivin e AK në përqindje me kontratën e bashkëpunimit. KPP gjykon se për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për kontratat e ngjashme, operatorët ekonomik duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontrata të njëjta, pasi në këtë rast do të quheshin kontrata të njëjta ato kontrata që përmbajnë të gjitha zërat që përmban preventivi i punimeve që tenderohen, gjë e cila është pothuajse e pamundur, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Gjithashtu vlen të theksohet se vlera e përgjithshme e punimeve të ngjashme të realizuara në kontratat e paraqitura nga ky operator ekonomik, e tejkalon vlerën prej 40% të dyfishit të fondit limit. Në këto kushte, KPP gjykon se BOE ankimues e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në shtojcën nr. 10, pika 2.3 "Kapaciteti teknik" në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k. qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimet e BOE ankimues "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. dhe BOE ankimues "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k., lidhur me vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi ose kërkesat për të lënë në fuqi vendimin e KVO-së për skualifikimin e tyre, me argumentin se këta operatorë nuk plotësojnë kriteret e vecanta të kualifikimit. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në nenin 63 pika 1.1. dhe pika 2 e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës. kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përbërësit, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik, Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrative pranë autoritetit kontraktor (rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për

Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura, pasi autoriteti kontraktor dhe vetë KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave kryesisht. Si rregull, investimi i K.Sh.A dhe KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar.

III.3.3. Sa më sipër, KPP gjykon se operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar jo vetëm përpara Komisionit të Prokurimit Publik por edhe përpara autoritetit kontraktor, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se, mospërmbushja e kriterit mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.3.4. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson dallimin e qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësinë e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krahasim të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP dhe KSHA adaptojnë një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i KVO-së ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.3.5. Në këto kushte, konstatohet se BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. dhe BOE ankimues "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k., në ankimin e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, nuk i kanë parashtruar të gjitha arsyet për skualifikimin e operatorëve të tjerë nga kjo procedurë prokurimi, por kanë ngritur pretendime në total, pa dhënë prova fakte dhe argumenta, e rrjedhimisht ankimi i paraqitur prej tyre nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi për faj të vetë ankimuesve, ankimi në autoritetin kontraktor nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik".

Sa më sipër, pretendimet BOE "EURALDI" sh.p.k. & "CURRI" sh.p.k. dhe BOE ankimues "VLLAZNIA NDËRTIM IS" sh.p.k. & "NDREGJONI" sh.p.k., lidhur me vendimin e KVO-së për

kualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë apo lënien në fuqi të vendimit të KVO-së për skualifikimin e tyre nuk do të merret në shqyrtim.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e BOE ”EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Sistemim asfaltim rruga e fshatrave Grazhdan, Pilafe, Majtare e Poshtëme dhe Lagjes Aksioni, Peshkopi*”, me nr. REF-21545-07-19-2017, me fond limit 50,971,385 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.08.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Dibër.
2. Të pranojë ankesën e BOE ”VLLAZNIA NDËRTIM IS” sh.p.k. & “NDREGJONI” sh.p.k., lidhur me shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre, për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE ”EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k. dhe BOE ”VLLAZNIA NDËRTIM IS” sh.p.k. & “NDREGJONI” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet duke i kualifikuar këta operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE ”EURALDI” sh.p.k. & ”CURRI” sh.p.k. dhe BOE ”VLLAZNIA NDËRTIM IS” sh.p.k. & “NDREGJONI” sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1452 protokoli Datë 08.09.2017; Nr. 1455 protokoli Datë 08.09.2017;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar

Leonard Gremshi

Anëtar

Hektor Balluku

Anëtar

Kleves Janku

Anëtar

Odise Moçka

Kryetar

Evis Shurdha